REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2152/9 Prot. Tiranë, më 30.10 2026

VENDIM

Nr. 143 dt. 30.10 2026

"PËR
MIRATIMIN E ANGAZHIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK TË FTUAR PËR PROGRAMIN E PËRBASHKËT "MASTER I SHKENCAVE" NË "SHKENCA SPORTIVE" NDËRMJET FSHL-SË DHE UNIVERSITETIT "CARLO BO" TË URBINOS, ITALI"

Mbështetur në nenin 3, 38, 62 të Ligjit nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë*", në Vendimin nr.57, datë 29.01.2020 "*Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë*", në nenin 7, 20, 55 të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, në nenin 7, 35 të Rregullores së UST-së, në nenin 20 te Rregullores së FSHL, në Rregulloren e Rekrutimit të Personelit akademik dhe ndihmës akademik të UST-së, Modaliteti D *"Personeli Akademik i ftuar"*, shkresën e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes me nr. 2125/1 prot., datë 28.10.2010 "*Përcjellje e propozimit për angazhim të personelit akademik të ftuar në Departamentin e Edukimit dhe Shendetit në FSHL për vitin akademik 2026-2027*", në Vendimin e Rektoratit nr.130, datë 28.10.2026, në kuadër të bashkëpunimit akademik ndërmjet Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Universitetit "Carlo Bo" të Urbinos, Itali, Senati Akademik në mbledhjen e datës 30.10.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e angazhimit të personelit akademik të ftuar për programin e përbashkët "Master i Shkencave" në "Shkenca Sportive" ndërmjet FSHL-së dhe Universitetit "Carlo Bo" të Urbinos, Itali.

2. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Bordit të Administrimit si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Agron KASA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI I SPORTEVE - TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES
DEKANI

Nr. 2125/1 Prot. Tiranë, më 28.10.2026

Lënda: Përcjellje e propozimit për angazhim të personelit akademik të ftuar në Departamentin e Edukimit dhe Shëndetit në FSHL për vitin akademik 2026-2027

REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS ✓

PROF.DR. AGRON KASA

ADMINISTRATORES SË UST-SË

ZNJ. HAXHIRETE SULAJ

Për dijeni: ZV/REKTORI PËR ANËN MËSIMORE
Prof.Dr.Dhimitraq PRIFTI

I Nderuar Z/Rektor!

Mbështetur në nenin 62 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; neni 55 të Statutit të UST, neni 35 të Rregullores së UST; neni 20 të Rregullores së FSHL; në "Rregulloren e Rekrutimit të personelit akademik dhe ndihmës akademik të UST-së", Modaliteti "D" "*Personeli akademik i ftuar*", si dhe në kuadër të bashkëpunimit akademik ndërmjet Universitetit të Sporteve të Tiranë dhe Universitetit" "Carlo Bo" të Urbinos, Itali, në kërkesën nr. 2125 prot, dt. 26.10.2026, të Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, ju paraqesin popozimin si vijon:

Për realizimin e programit të përbashkët të studimit "Master i Shkencave " në "Shkenca Sportive" ju përcjellim propozimin për angazhimin si lektor i ftuar **Prof.Asc.Dr. Giosuè Anibalini**, pjesë e personelit akademik të Universitetit "Carlo Bo" të Urbinos, Itali.

Lënda: "Biokimia Metabolike e Ushtrimeve Fizike dhe Sportit" (Master i Shkencave" në "Shkenca Sportive)
Moduli: "Biokimia e Ushtrimeve Fizike"– 10 orë leksione

Bashkëlidhur po Ju dërgojmë
- Curriculum Vitae
- Informacionin mbi veprimtarinë e tij kërkimore - shkencore të ardhur nga Departamenti i interesuar.

Faleminderit për mirëkuptimin.

DEKANI

Prof. Asc. Dr. Enkelejda LLESHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT DHE SHËNDETIT

Nr. 2125 Prot. Tiranë, më 26.10.2026

Lënda: Propozim për angazhimin e personelit akademik të ftuar në programin e përbashkët të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Sportive"

DEKANIT TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË LËVIZJES

PROF.ASC.DR. ENKELEIDA LLESHI

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 62, Statutin e UST-së, neni 55, Rregulloren e UST-së, neni 35, Rregulloren e FSHL-së, neni 20, si dhe Rregulloren e Rekrutimit të UST-së, germa D, "Personeli akademik i ftuar";

Në kuadër të bashkëpunimit akademik ndërmjet Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Universitetit "Carlo Bo" të Urbinos, Itali, për realizimin e programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Shkenca Sportive", **Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit propozon angazhimin si lektor të ftuar të Prof. Asc. Dr. Giosuè Annibalini**, pjesë e personelit akademik të Universitetit "Carlo Bo" të Urbinos, Itali.

Angazhimi i tij propozohet për zhvillimin e lëndës **"Biokimia Metabolike e Ushtrimeve Fizike dhe Sportit"**, pjesë e modulit "Biokimia e Ushtrimeve Fizike", në vitin e parë, semestri i parë të programit të studimit, me një ngarkesë mësimore **10 orë leksione.**

Ky propozim synon të mbështesë realizimin e programit të përbashkët të studimit, të forcojë bashkëpunimin akademik ndërmjet dy institucioneve dhe të kontribuojë në rritjen e cilësisë së procesit mësimor në fushën e shkencave sportive.

Bashkëlidhur kësaj shkrese përcillen dokumentet e mëposhtme:

- Curriculum Vitae (CV) e kandidatit;
- Informacion mbi veprimtarinë e tij kërkimore-shkencore.

Për sa më sipër, kërkojmë shqyrtimin dhe miratimin e propozimit për angazhimin e Prof. Asc. Dr. Giosuè Annibalini si lektor i ftuar në programin e përbashkët të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Sportive".

DREJTUESE E DEPARTAMENTIT

Prof.Asc.Dr. Rigerta SELENICA